



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.16

Prishtinë, më 03.06.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Serdjan Popović, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik,.

Pjesëmarrës të tjerë: Arsim Bajrami-MASHT, Mahir Yağcılar-MAPL, Fitim Sadiku, Birsen Shufta, Faton Fetahu, Blendina Krasniqi- UNDP (praktikante), Petrit Hysaj-OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 27.05.2015;
3. Diskutim lidhur me kolizionin e ligjeve që rregullojnë marrëdhënien e punës në fushën e arsimit. Të ftuar përfaqësuesit e MASHT, MAPL, MPMS;
4. Shqyrtimi i planit të veprimit për monitorim të Ligjit për Arsimin Parauniversitar;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.05.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.05.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me kolizionin e ligjeve që rregullojnë marrëdhënien e punës në fushën e arsimit. Të ftuar përfaqësuesit e MASHT, MAPL, MPMS;

Nait Hasani, theksoi se nga vizitat nëpër Komuna dhe takimet me drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit, jemi njoftuar me problemet që dalin nga kolizioni i ligjeve që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës në fushën arsimit. Ai shtoi se Komuna e Ferizajt i ka dërguar Komisionit një shkresë në të cilën janë paraqitur vërejtjet konkrete që kanë të bëjnë me kolizionin e ligjeve të fushës së arsimit, shërbimit civil dhe ligjit të punës.

Arsim Bajrami, tha se Ministria e Administratës Publike ka marrë përsipër të përgadis legjislacionin sekondar në mënyrë që të definohet qartë statusi i mësimëdhënësve në të gjitha nivelet dhe i udhëheqësve të shkollave. Ministria e Arsimit po punon në krijimin e një kornize ligjore dhe një standardi që drejtorët e shkollave t'iu përgjigjen Këshillit të Prindërve dhe nxënësve e sa më pak kryetarëve të Komunave. Në vazhdim tha se vlerësimi i aftësive psiko-fizike të profesorëve mbi moshën 50 vjeçare dhe çështja e pensionimit të tyre të parakohëshëm do të diskutohet me Ministrinë e Administratës Publike, që kjo çështje ti delegohet Ministrisë së Arsimit në bashkëpunim me Komisionin për Arsim për përgaditjen e ndryshimeve për Ligjin e Arsimit Parauniversitar dhe për Ligjin e Shërbimit Civil.

Mahir Yağcılar, tha se sipas Ligjit për Shërbimin Civil, në nenin 4, statusi i nënpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e stafit të sistemit arsimor, lidhur me këtë tha se duhet të bëjmë ndryshime që kjo çështje të rregullohet me ligjet e fushës së arsimit. Ai theksoi se jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me Komisionin dhe me Ministrinë e Arsimit sepse duhet ti dimë qartë përgjegjësitë e shërbimit civil, nënpunësit civil dhe zyrtarëve të tjerë të cilët nuk do të përfshihen në kategoritë si shërbyes dhe nënpunës civil.

Fitim Sadiku, tha se aktualisht drejtorët e shkollave me ligj kanë statusin e nënpunësit civil mirëpo ky fakt ka paraqitur probleme në praktikë dhe ka shkaktuar vështirësi për arsye se përzgjedhja e drejtorëve përcaktohet ndryshe nga ajo që parasheh Ligji për Arsim dhe nuk është rregulluar me procedurë të qartë rekrutimi, vlerësimi i punës dhe procedura e pushimit. Në vazhdim tha se ende nuk e kemi të rregulluar çështjen e të punësuarve jashtë shërbimit civil pra kemi ligjin por nuk kemi akte nënligjore që e rregullojnë këtë çështje dhe çështja e drejtorëve të shkollave është problematike dhe duhet të definohet, pavarësisht se me cilin ligj do të bëhet.

Nait Hasani, pyeti për çështjen e pushimit të lehonisë se si bëhen ato pushime dhe zëvendësimet.

Arsim Bajrami, tha se në grantin specifik që e kemi aprovuar e kemi paraparë buxhetin për zëvendësim të përkohëshëm të punëtoreve që janë në pushim të lehonisë.

Mahir Yağcılar, tha se sa i përket lehonisë kjo çështje është rregulluar në mandatin e kaluar me Ministrinë e Mirëqenies Sociale. Në vazhdim tha se në Qeveri kemi marr vendim që përvoja e punës të paguhet 0.5 % për çdo vit.

Nait Hasani, pyeti për çështjen e diplomave të të diplomuarve në kolegjet private.

Arsim Bajrami, tha se janë tre institucione që kanë dhënë diploma në sektorin publik pa licencë, kolegji i Gjilanit, kolegji Dukagjini dhe Universiteti Evropian, këto diploma në aspektin ligjor nuk janë valide sepse ligji është i qartë që asnjë institucioni privat nuk mund ti jepet e drejta të zhvillojë veprimtari arsimore pa licencë. Ai tha se numri total i mësimëdhënësve me diploma të pa licencuara është rreth 300 dhe nuk u kemi dhënë asnjë shpresë për legjitimim të këtyre diplomave.

Srdjan Popović, pyeti ministrin se çfarë ka bërë ministria lidhur me çështjen e njohjes së diplomave të Universitetit të Mitrovicës veriore.

Arsim Bajrami, tha se çështja e pranimit të diplomave të lëshuara në Universitetin e Mitrovicës veriore është një çështje ligjore e cila duhet zgjedhur me aplikimin e këtij institucioni për akreditim në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës. Ne këtë rast përmendi edhe çështjen e njohjes së diplomave në Luginë të Preshevës përmes reciprocitetit.

Shpejtim Bulliqi, tha se problemet që janë paraqitur nëpër komuna janë si pasojë e mos harmonizimit të ligjeve, me këtë rast propozoj të krijohet një komision për harmonizimin e tyre. Sa i përket kontratave të përhershme tha se duhet të bëhen për ata të cilët janë të kualifikuar dhe që i plotësojnë kushtet dhe theksoi se problem tjetër është edhe koeficienti i ndryshëm i pagave të punëtorëve. Në vazhdim propozoi që çështja e emërimit të shkollave ti delegohet Komunave.

Arsim Bajrami, tha se Udhëzimi Administrativ për kontratën e përhershme është përgaditur dhe nga 15 gushti në të gjitha Komunat në mënyrë obligative fillon shpërndarja e kontratave. Sa i përket emërimit të shkollave tha se është kompetencë që nuk i duhet Ministrisë së Arsimit dhe përgjegjësinë duhet ta marrin drejtorët e komunave. Ai theksoi se ligji për pagat është në finalizim dhe tek profesorët me tituj të masterit kemi paraparë përqindje shtesë.

Mahir Yağcılar, tha se në ligjin e ri për paga do të përfshihen të gjithë përfituesit nga buxheti i shtetit dhe në një grup të vaçantë do të jetë sistemi i arsimit sipas propozimeve nga Ministria e Arsimit, ky do të jetë një sistem i unifikuar dhe shumë më efikas.

Nait Hasani, tha se janë tri shkolla të cilat kanë filluar ndërtimin në vitin 2009 dhe nuk janë finalizuar për shkak të mungesës së buxhetit.

Arsim Bajrami, tha se ka shumë shkolla që kanë mbetur pa u finalizuar dhe ata që kanë kontratë për ndërtim të këtyre shkollave janë të obliguar ti perfundojnë dhe në qoftëse nuk i përmbushin këto obligime duhet të penalizohen.

Mahir Yağcılar, tha se pas kërkesës nga Ministria e Arsimit që çështja e ndërtimit të transferohet te ne dhe sipas memorandumit të mirëkuptimit jemi përgjegjës ti realizojmë këto ndërtime. Ai tha se besoj që kjo çështje sipas ligjit të kalohet në kompetencë të komunave.

Ismajl Kurteshi, pyeti lidhur me çështjen e shkëputjes së kontratave të punës për shkak të diplomave të palicencuara. Sa i përket çështjes së drejtorëve të shkollave tha se ata duhet të zgjedhën nga Këshilli i Prindërve kurse mandati i tyre të varet nga performanca, ndërsa lidhur me pagat tha se ato janë të ndryshme edhe përkundër kualifikimeve të njëjta.

Teuta Haxhiu, tha se çështja e drejtorëve të shkollave nuk është e rregulluar me ligj dhe kam argumente që Këshilli shpesh herë ka lëshuar vendime për ti kthyer në punë disa nga ish drejtorët politikisht. Ajo theksoi se çështja e pensionimit të parakohshëm duhet të rregullohet sepse ka mësimdhënës të sëmurë dhe me këtë pësojnë nxënësit. Në vazhdim tha se janë dikur rreth 305 mësimdhënës në Kosovë nga kolegjet private, shumica prej tyre janë nga AAB-ja dhe kjo çështje duhet të rregullohet sepse kontratat e tyre nuk dihet se kush i ka lëshuar.

Mufera Sinik, falënderoj ministrin për nxjerrjen e udhëzimit administrativ për përfshirjen e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla.

Shukrije Bytyqi, tha se çështja e zgjedhjes së drejtorëve duhet të rregullohet, drejtorët ti raportojnë Këshillit të Prindërve. Në Ligjin për Arsimin Parauniversitar duhet të parashihet një dispozitë që parasheh bashkëpunimin në kujdestarëve të klasave dhe prindërve. Ajo theksoi se duhet të bëhet harmonizimi i ligjeve të çështja e pushimit të lehonisë. Në vazhdim theksoi se ka mësimdhënës nga kolegjet private jo vetëm në shkollat fillore por edhe në shkollat e mesme dhe është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit dhe kolegjeve private që të ndalojnë këto parregullsi.

Bekim Haxhiu, tha se drejtorët e shkollave janë bërë drejtor politik dhe nuk mund të presim cilësi në arsim kur ka drejtor që ushtrojnë ndikime politike te mësimdhënësit. Ai theksoi se jemi duke punuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe besojë që shumë çështje do ti rregullojmë me këtë ligj dhe kërkoi që çështja e profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë të rregullohet me një memorandum mirëkuptimi sepse ka probleme dhe ngritja akademike e stafit mësimdhënës të Fakultetit të Mjekësisë të bëhet përmes ligjit të Arsimit të Lartë ndërsa të tjerët të paguhet dhe të vlerësohen në bazë të ngritjes profesionale dhe akademike në Qendrën Klinike Universitare sepse niveli i pagave nuk është i njëjtë, profesionet shëndetësore në nivele të spitaleve paguhet për profesionin e njëjtë më shumë se ata që janë në Qendrën Klinike Universitare. Ai kërkoi që

bashkarisht Ministria e Administratës Publike, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë të rregullojnë këtë çështje.

Arsim Bajrami, tha se asnjë diplomë e mësimëdhënësve në sferën e edukimit nga kolegjet private të pa licensuara nuk do të ketë validitet, sa i përketë zgjedhjes së drejtorëve tha se duhet të ketë sa më shumë kritere për përzgjedhje dhe të krijohet njësitë i inspektoriatit që monitoron procesin dhe përgjegjësia për zgjedhjen e drejtorëve tu kaloj shkollave. Ai tha se kemi rreth 100 mësimëdhënës me aftësi të kufizuara psiko-fizike, kjo është e patolerueshme por nuk është në kompetencë të Ministrisë së Arsimit ti pensionoj parakohshëm por është në kompetencë të Ministrisë së Administratës Publike që të na mundësojë që të blejmë stazhin e punës. Në vazhdim tha se asnjë diplomë e institucioneve të arsimit privat që është e licensuar dhe e akredituar nuk kontestohet dhe bëhet shkelje e ligjit nëse diskriminohen studentët që kanë diploma valide të kolegjeve private, vetëm diplomat e edukimit nuk janë të licensuara.

Mahir Yağcılar, tha se për herë të parë në Republikën e Kosovës po bëhet një ligj që rregullon çështjen e pagave për të gjithë dhe besojmë se do të eliminohet ky ndryshim i koeficientit. Ai theksoi se çështja e pensionimit të parakohshëm duhet të rregullohet në parim me ligjin e punës ose me një ligj të veçant.

4. Shqyrtimi i planit të veprimit për monitorim të Ligjit për Arsimin Parauniversitar

Nait Hasani, tha se kryesuesi i Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, ka hartuar një plan të veprimit sipas të cilit parashihen aktivitetet dhe afatat kohore për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Anëtarët e Komisionit përkrahen planin e veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar.

5. Të ndryshme

Nait Hasani, tha se ka një kërkesë nga Shoqata Kulturore Shqiptare “Mëmëdheu” në Zvicër, për gjetjen e një hapësire publike për ndërtimin e një Memoriali për Adem Demaçi. Ai propozoi që kjo kërkesë ti adresohet Ministrisë së Kulturës dhe drejtorisë së Kulturës në Komunën e Prishtinës dhe Urbanizmit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani